



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3171 Prot.

Vlorë, më 09.10.2018

VENDIM

Nr. 37, datë 28.09.2018

PROPOZIM PËR PËRFITIM PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.09.2018 në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, nenit 5 të Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” si dhe kërkesës së Z. Abaz ARAPI për përfitim pensioni të posaçëm shtetëror,

VENDOSI;

- 1.Ti propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhënien e Pensionit të Posaçëm Shtetëror **Z. Abaz Kalo ARAPI**, për kontributin e dhënë në zhvillimin e arsimit dhe përkushtimin në edukimin e brezave të rinj.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë Nr. _____ Prot, datë _____ .2018.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.
Tel: +355 33 421 600